



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 400 Prot.

Tiranë, më datë 13.09.2024

VENDIM

Nr. 352, datë 13.09.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 13.09.2024:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor në kuadër të projektit “Centrali Fotovoltaik 93 MW Libohovë dhe nënstacioni linja e transmetimit”, Bashkia Libohovë”, me zhvillues subjekti **Faathon sh.p.k.**;
2. Të realizohen sondazhe arkeologjike para fillimit të punimeve për rrënojat e mureve të identifikuara në traktin nr.8, si dhe në shtyllat e linjës elektrike nr. 33, 34, 35, 39 dhe 40, të cilat ndodhen pranë “Urës së Zonjës”, me status Monument Kulture e Kategorisë së I-rë;
3. Koncepti i sondazheve arkeologjike i hartuar nga subjekti i licencuar në arkeologji, duhet të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;
4. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve për projektin “Centrali Fotovoltaik 93 MW Libohovë dhe nënstacioni linja e transmetimit”, Bashkia Libohovë”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

